



Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Emri i grupit</b>	Specialistë të Gjeodezisë
<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar për Kadastër
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 2
<b>Koeficienti/Paga</b>	5-8
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	07/02/2024
<b>Afati për aplikim</b>	08/02/2024 - 08/03/2024
<b>Institucioni</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>Departamenti</b>	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operatives
<b>Divizioni</b>	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operatives
<b>Vendi i punës</b>	Prizren
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00013263
<b>Kodi</b>	RPC0006802



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Bashkëpunon me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Zyrat Komunale Kadastrale, kompanitë private të licencuara dhe Zyrat Regjionale të AKP-së për identifikimin, regjistrimin, dhe azhurnimin e pasurive të paluajtshme të Ndërmarrjeve Shoqërore në regjistrat zyrtar kadastral. Ndhmon departamentet tjera të AKP-së lidhur me përgatitjen e hartave tematike që lidhen me procesin e privatizimit/likuidimit për pronat e ndërmarrjeve shoqërore ku është e nevojshme dhe e mundshme;
- Bashkëpunon me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, Zyrat Komunale Kadastrale, dhe Zyrat Regjionale të AKP-së, si dhe ndihmon zyrtaret tjerë në kuadër të Zyrës Regjionale e në veçanti zyrtarët përgjegjës për privatizim dhe likuidim të pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Siguron dhe mbledh të dhënat relevante kadastrale që janë në dispozicion. Të dhënat kadastrale nënkuptojnë: shënimet kadastrale (parcelat), Certifikatat e Pronësisë, objektet dhe të dhënat e tjera që kanë të bëjnë me pronat e paluajtshme të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Realizon digjitalizimin e hartave kadastrale (dhe realizon kontrollimin e shënimeve aktuale digjitale), bënë përgatitjen e hartave tematike (duke përfshirë matjet e nevojshme dhe raportin nga terreni) dhe bënë analizat e nevojshme të patundshmërive të Ndërmarrjeve Shoqërore për qëllime të privatizimit/likuidimit;
- Merr pjesë aktive në analizat kadastrale të nevojshme dhe siguron implementimin e realizimit të regjistrimit të pronave të patundshme të Ndërmarrjeve Shoqërore në rastet kur paraqitet nevoja dhe mundësia;
- Punon në zhvillimin e Data bazës kadastrale dhe ofron shpjegime dhe informata të mjaftueshme për parcelat kadastrale (formën, sipërfaqen, vend-ndodhjen, sipërfaqet kontestuese, pronarin, hipotekat, pengun etj.) të pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Bashkëpunon me anëtarët tjerë të Divizionit, duke përfshirë edhe partneret tjerë të AKP, që të formoj dhe siguroj përfshirjen sa më të mirë të pronave të paluajtshme të Ndërmarrjeve Shoqërore në kuadër të ndërmarrjeve të reja të krijuara me qëllim të privatizimit/likuidimit.
- Siguron mbështetje të vazhdueshme për identifikimin (në zyre dhe në terren) e ndërtimeve joligjore në pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore si dhe siguron të dhëna të mjaftueshme kadastrale dhe pronësore për analizimin, përshkrimin dhe identifikimin e patundshmërive në të cilat ekzistojnë ndërtime joligjore;

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

**Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 (tre) vite të studimeve në Gjeodezi;

**Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë profesionale në fushën e Kadastrit;

### 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit në mënyrë efektive si brenda ashtu edhe jashtë Agjencisë;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve të mëposhtme softuerike: MS Excel, MS Word, MS Outlook, MS Power Point, GeoMedia Professional, AutoCAD;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe në të folur dhe në të shkruar;
  - Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

### 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

Aplikacioni i cili plotësohet online me rastin e aplikimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);

- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;

Certifikatat e trajnimeve

- Dëshmi për përvojën e punës / vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Letër motivimi;
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe

cdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 23/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 7.Kriteret specifike shtesë

---

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

